

## QENDRA E BURIMEVE PËR SHOQËRI CIVILE NË KOSOVË

### UDHËZIMET PËR APLIKIM NË KUADËR TË GRANTEVE PËR VULLNETARIZËM

#### **HYRJE**

Qendra e Burimeve për Shoqëri Civile në Kosovë ka për qëllim të zhvillojë kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë përmes trajnimeve të përshtatura dhe të dizajnuara në bazë të nevojave të OShC-ve, mentorimit të drejtpërdrejtë në punën që bëjnë, si dhe përmes ndarjes së informatave të vazhdueshme për aspektet kryesore të zhvillimit organizativ dhe të qytetarisë aktive, në përgjithësi. Përveç kësaj, Qendra zbaton skemën e granteve për vullnetarizëm që ka për qëllim mbështetjen e nismave për aktivizëm qytetar dhe promovim të vullnetarizmit në vend.

Grantet për vullnetarizëm kanë për qëllim arritjen e rezultateve konkrete brenda një kornize të caktuar kohore. Përfituesit e këtyre granteve mund të jenë individët, iniciativat e paregjistruara dhe organizatat joqeveritare që prezantojnë propozimet më bindëse dhe më kreative, të cilat kanë potencial të lartë për t'i angazhuar qytetarët dhe qytetaret e Kosovës në adresimin e çështjeve të komunitetit ku ata jetojnë.

#### **1. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR**

Angazhimi dhe puna vullnetare i inkurajon njerëzit që të jenë më aktiv në jetën publike dhe, në të njëjtën kohë i mundëson atyre që të krijojnë raporte të reja të ndërveprimit në mes të sektorëve, komuniteteve dhe vendbanimeve të ndryshme. Po ashtu, angazhimi vullnetar kontribuon në rritjen e solidarizimit dhe bashkëveprimit në mes të njerëzve, kështu duke krijuar një ambient më të sigurt dhe qytetarë e qytetare që angazhohen për adresimin e çështjeve me interes publik, përkrahje të grupeve në nevojë dhe komunitetit të gjerë, në përgjithësi<sup>1</sup>.

Kosova ka një shoqëri civile aktive dhe diverse, e cila vazhdimisht ka kontribuar dhe ka rol esencial në demokratizimin e vendit dhe proceset vendimmarrëse në dy dekadat e fundit. Po ashtu, të dhënat historike të matjes së besimit të qytetarëve ndaj sektorëve/institucioneve të ndryshme e listojnë shoqërinë civile në mesin 2-3 institucioneve më të besueshme. Më konkretisht, të dhënat e anketës me qytetarë tregojnë që 52% e qytetarëve të Kosovës i besojnë punës që shoqëria civile bën. Megjithatë, numri i qytetarëve që angazhohen dhe përfshihen në aktivitete të organizatave të shoqërisë civile është relativisht i ulët. Të dhënat nga anketa me qytetarë<sup>2</sup> tregojnë se vetëm 3.7% e qytetarëve kanë qenë të angazhuar si vullnetarë nëpër OShC ose të kanë mbështetur ndonjë kauzë të ngritur nga shoqëria civile (4.8%). Shifrat janë relativisht të ngjashme sa i përket qytetarëve që marrin

---

<sup>1</sup> Newkirkt, J.A., et.al., (2017), 'Mid-term Evaluation of the Civil Society Facility for the Western Balkans and Turkey', Raporti i CSF-së për vlerësim, Komisioni Evropian.

<sup>2</sup> Studimet e KCSF-së mbi popullatën, 2020.

pjesë në punën e OShC-ve ose që ofrojnë ndonjë mbështetje financiare për OShC-të. Vetëm rreth 4% të qytetarëve raportuan të kenë marrë pjesë në aktivitetet e OShC-ve, ndërsa më pak se 3% të kenë dhuruar fonde për të mbështetur punën e cilësdo OShC.

Me qëllim të rritjes së potencialit për ndikim më të madh, rritjes së besimit ndërpersonal dhe kohezionit shoqëror, OShC-të duhet të bëjnë më shumë përpjekje për komunikim të rregullt dhe përfshirje të grupeve të ndryshme të qytetarëve në punën e tyre. Po ashtu, duke pasur parasysh besueshmërinë që gëzon shoqëria civile, ajo mbetet një nga mediumet më të vlefshme për promovimin dhe zhvillimin e kulturës së angazhimit në komunitet dhe të vullnetarizmit për çështjet e së mirës publike.

#### a. Çfarë janë Grantet për Vullnetarizëm?

Grantet për vullnetarizëm kanë për qëllim mbështetjen e nismave për aktivizëm qytetar dhe promovim të vullnetarizmit në vend, dhe arritjen e rezultateve konkrete brenda një afati të caktuar kohor. Përfituesit e këtyre granteve mund të jenë individët, iniciativat e pargjistruara dhe organizatat joqeveritare që prezantojnë propozimet më bindëse dhe më kreative, të cilat kanë potencial të lartë për t'i angazhuar qytetarët dhe qytetaret e Kosovës në adresimin e çështjeve të komunitetit ku ata jetojnë. .

## 2. **KËRKESAT E PËRGJITHSHME TË THIRRJES**

### A. Kush mund të aplikojë?

Për të aplikuar, të interesuarit duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Të jenë individë, iniciativa të pargjistruara ose OJQ aktive në Kosovë, që janë të angazhuar/a në çfarëdo initiative jofitimprurëse;
- Të kenë qarkullim vjetor jo më shumë se 25,000 euro gjatë tre viteve të fundit (vlen vetëm për OJQ-të);
- Të jenë përgjegjës në mënyrë të drejtpërdrejtë për menaxhimin e grantit (*partneritetet me OJQ-të/iniciativat e pargjistruara lejohen vetëm nëse aplikanti kryesor merr përgjegjësinë e plotë për implementimin dhe menaxhimin e projektit*);
- Të dëshmojnë se posedojnë kapacitete për menaxhimin e aktiviteteve të propozuara;
- Të mos udhëhiqen apo menaxhohen nga personat e ekspozuar politikisht.<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Për më shumë informata në lidhje me personat e ekspozuar politikisht shikoni shabllonin e formularit për aplikim.

a. Individët dhe iniciativat e peregjistruara

Kjo thirrje inkurajon fuqishëm aplikimin nga ana e individëve dhe iniciativave të peregjistruara. Në rastet kur aplikantët janë individë ose iniciativa të peregjistruara, ata duhet të dëshmojnë se angazhimi i tyre nuk synon ndonjë fitim, por ka për qëllim përfitimin publik. Ata gjithashtu duhet të dëshmojnë se i plotësojnë në mënyrë adekuate kriteret përkatëse të pranueshmërisë. Të gjitha kërkesat tjera në lidhje me administrimin e granteve janë të zbatueshme sikurse për organizatat joqeveritare.

b. Organizatat joqeveritare (OJQ)

Pavarësisht statusit të tyre ligjor, jo të gjitha OJQ-të përfshihen në kriteret e lartcekura të pranueshmërisë. Për shkak të fushëveprimit gjithëpërfshirës të legjislacionit në fuqi në Kosovë për regjistrimin e OJQ-ve, klubet sportive, federatat e sportit, shoqatat kulturore amatore (ansamblet e vallëzimit popullor) ose organizatat fetare të regjistruara si OJQ nuk janë synim këtyre granteve. Në mënyrë të ngjashme, OJQ-të që përfaqësojnë biznese ose subjekte të ngjashme, të cilat posedojnë kapacitete evidente financiare për të mbuluar kostot e organizatës së tyre ose për të mbështetur aktivitetet e tyre nuk janë të shënjestruara për këto grante.

c. Kohëzgjatja dhe buxheti

Kohëzgjatja e projektit nuk duhet të jetë më e gjatë se 12 muaj.

Buxheti maksimal që kërkohet për financim në kuadër të kësaj thirrjeje nuk duhet të tejkalojë vlerën prej **5,000.00** (pesë mijë) EUR.

d. Fushat e intervenimit

Përmes kësaj thirrjeje për propozime, KCSF dhe CBM do të mbështesin iniciativat që kontribuojnë në mobilizimin e vullnetarëve dhe promovojnë punën vullnetare për të nxitur solidaritetin, përgjegjësinë sociale dhe qytetarinë aktive.

Në vijim paraqitet lista sqaruese e fushave dhe iniciativave që mund të financohen në kuadër të kësaj thirrjeje.

Iniciativat e vullnetarizimit duhet të jenë të përfshira në njërin ose më shumë fushë/fusha të intervenimit si më poshtë:

- Fuqizimi i të rinjve;
- Mbrojtja e mjedisit;
- Shëndeti publik;
- Integritet gjinor;
- Trashëgimia kulturore;
- Përfshirja sociale;

Shembujt e aktiviteteve mund të përfshijnë iniciativat e vullnetarizimit të cilat:

- promovojnë vullnetarizmin dhe angazhimin e të rinjve në proceset vendimmarrëse në komunitetet e tyre përkatëse (p.sh. mund të përfshijë propozimin e ndryshimit të politikave në qeverisjen lokale, këshillin e fshatit, këshillin e shkollës, pjesëmarrjen në konsultime në nivel lokal, ofrimin e edukimit në sferën e njohurive financiare etj.);
- angazhojnë të rinjtë në aktivitetet e avokimit dhe mobilizimit në lidhje me përfshirjen sociale; (p.sh. iniciativat e avokimit që trajtojnë çështjet e sigurisë publike të qytetit, fshatit ose lagjes; organizimi i mbledhjeve të tryezave të rrumbullakëta për planifikimin buxhetor me komunën etj.);
- aktivitetet që mobilizojnë vullnetarët në mbrojtjen e mjedisit, e që janë të dobishme për komunitetin e gjerë; (p.sh. aktivitetet e riciklimit, promovimi dhe mbrojtja e mjedisve natyrore, aktivitetet publike për ngritjen e vetëdijes në lidhje me rëndësinë e klasifikimit të mbeturinave etj.);
- aktivitetet që mobilizojnë vullnetarët në promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe diversitetit kulturor të komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë; (p.sh. ngritja e njohurive për trashëgiminë e përbashkët kulturore përmes vizitave në terren, promovimit të aseteve kulturore si mjet për zhvillimin e turizmit etj.);
- mbajtjen e ligjëratave dhe debateve publike mbi edukimin e të rinjve në lidhje me shëndetin publik dhe shëndetin seksual (p.sh. mundësia e qasjes në produktet higjienike, edukimi ndërmjet moshatarëve në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues, etj.);
- promovojnë barazinë gjinore, me fokus të veçantë në trajtimin e stereotipeve gjinore për të rinjtë dhe nxitjen e promovimit të integritit gjinor (p.sh. aktivitetet që trajtojnë luftën kundër diskriminimit në të gjitha nivelet; pjesëmarrjen dhe avokimin për promovimin e buxhetimit gjinor etj.);
- përfshijnë aktivitetet që mobilizojnë të rinjtë në promovimin e komunikimit dhe bashkëpunimit midis komuniteteve në Kosovë për adresimin e çështjeve të përbashkëta (p.sh. debatet publike, punëtoritë, demonstrimet në rrugë, etj.);
- rishikimi i hapësirave publike për të promovuar pjesëmarrjen e komunitetit, duke përfshirë rishfrytëzimin e hapësirave publike dhe ideve inovative rreth aktiviteteve sociale (p.sh. ndryshimi i synimit të përdorimit të hapësirave publike në lagje, ashtu që të mund të shfrytëzohet nga komuniteti, siç janë parqet, shkollat, qendrat kulturore etj.);

**Vërejtje: Të gjithë këta shembuj duhet të shërbejnë si pikë orientuese në hartimin e propozimit. Kjo nuk është një kërkesë obligative për të përfshirë aktivitetet specifike ashtu siç janë paraqitur më lartë. Aplikantët inkurajohen të sjellin idetë e tyre origjinale dhe kreative të cilat përkojnë me fushat e listuara më lartë**

Aplikacionet duhet të përmbajnë dhe përfshijnë pjesëmarrjen e barabartë të djemve dhe vajzave, burrave dhe grave të trajtojnë të drejtat dhe nevojat e tyre, personave me aftësi të kufizuara,

pjesëtarëve të pakicave të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian dhe serb, LGBTI, të moshuarve dhe të rinjve.

e. Niveli i intervenimit dhe mbulimi gjeografik

Përmes kësaj thirrjeje do të ofrohet mbështetje për iniciativat e shoqërisë civile anembanë Kosovës, të cilat kanë për qëllim të sjellin ndryshime në nivel lokal/komunal dhe/ose qendror. Në veçanti, të paktën gjysma e granteve do t'u ndahet aplikantëve me lokacion dhe veprimtari jashtë Prishtinës.

f. Angazhimi i qytetarëve dhe angazhimi vullnetar

Angazhimi i qytetarëve gjatë gjithë zbatimit të projektit të mbështetur, si dhe angazhimi vullnetar i të dyja palëve, zbatuesit të projektit dhe qytetarëve të përfshirë, janë elementet e rëndësishme që kërkohen për këto grante.

Nga aplikantët pritet të shtjellojnë se në çfarë mënyre synojnë t'i angazhojnë qytetarët, të identifikojnë dhe analizojnë qartë grupin e qytetarëve të synuar të cilët do të angazhohen përmes këtij granti, pse angazhimi dhe pjesëmarrja e tyre janë të rëndësishme për iniciativën e tyre dhe mënyrat e ndryshme që synojnë t'i angazhojnë ata. Gjatë këtij procesi, nga aplikantët pritet të jenë të vetëdijshëm për ndryshimet brenda qytetarëve të synuar (siç janë gjinia, mosha, përkatësia etnike, feja, edukimi, vendndodhja, rrethanat socio-ekonomike, interesat dhe nevojat, etj.) dhe të përshtasin propozimet dhe intervenimin e tyre në përputhje me rrethanat.

Nga aplikantët kërkohet gjithashtu të dëshmojnë se angazhimi i tyre, si dhe angazhimi i qytetarëve dhe akterëve tjerë realizohet mbi baza vullnetare. Në raste shumë specifike, kur është e domosdoshme pagesa e tarifave të caktuara simbolike për arritjen e qëllimit të projektit, aplikantëve u kërkohet të arsyetojnë një domosdoshmëri të tillë.

g. Qeverisja e brendshme

Qeverisja e brendshme e OJQ-ve mbetet një aspekt i rëndësishëm në përpjekjet për ta përmirësuar dhe ndërtuar besimin e qytetarëve në sektorin e shoqërisë civile dhe për të qenë në gjendje që organizatat të shërbejnë si shembull i qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut, në përgjithësi.

Të gjitha OJQ-të e përzgjedhura për financim do të mbështeten nga KCSF në lidhje me çështjet e praktikave të qeverisjes të mirë, menaxhimit të mirë financiar dhe parimeve të transparencës, anti-korrupsionit dhe llogaridhënies.

#### h. Grupet e rrjetëzimit

Për të nxitur një bashkëpunim më të madh në veprimet e përbashkëta ndërmjet përfituesëve të granteve, Qendra e Burimeve në Kosovë do të sigurojë platforma të ndryshme dhe vendtakime ku përfituesit e granteve mund të takohen, shkëmbejnë përvojat me njëri-tjetrin. Organizimi dhe veprimi i përbashkët rreth çështjeve me interes të përgjithshëm do të ishte një rezultat i synuar, prandaj pritet që përfituesit e granteve të jenë proaktivë në identifikimin e mundësive dhe dhënien e kontributit për të bashkëpunuar me iniciativat tjera vullnetare dhe të shoqërisë civile në fushat e tyre të interesit ose vendndodhjen e tyre gjeografike.

#### i. Temat horizontale

Integrimi gjinor si mjet për promovimin e barazisë gjinore do të jetë një çështje ndërlidhëse përgjatë të gjitha intervenimeve.

Si rregull i përgjithshëm, të gjithë grantistët e mbështetur pritet t'i shtrijnë intervenimet e tyre në mënyrë të barabartë mes gjinive, të jenë të kujdesshëm për efektet e intervenimit për burra e gra, djem e vajza, si dhe të mos kontribuojnë në stereotipa të dëmshëm. Të gjitha organizatat e mbështetura pritet t'i mbledhin dhe t'i ruajnë të dhënat të ndara sipas gjinisë. Për udhëzime lidhur me integrimin gjinor, ju lutemi shikoni dokumentin e shkurtër Udhëzues për aplikantët: Integrimi gjinor në webfaqen e KCSF-së.

### **3. PRANUESHMËRIA E AKTIVITETEVE DHE SHPENZIMEVE**

#### a. Intervenimet/aktivitetet e papranueshme

Intervenimet/aktivitetet në vijim nuk do të mbështeten:

- Intervenimet që ndërlidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me partitë politike ose që i mbështesin ato;
- Investimet kapitale;
- Grantet që përbëhen në tërësi apo kryesisht nga puna përgatitore dhe/ose studimet;
- Projektet dhe propozimet ndërkufitare për aktivitetet që do të implementohen jashtë Kosovës;
- Aktivitetet e llojit të shërbimit, siç është asistenca teknike;
- Fushatat për ngritjen e vetëdijes të cilat nuk kanë veprime të duhura pasuese;
- Intervenimet që u nënshtrohen varësisë dhe miratimit në shumë nivele, që paraqet rrezik të lartë për arritjen e rezultateve;
- Dhënia e granteve tek palët e treta;
- Programet e bursave.

Përveç nëse nuk janë të domosdoshme për arritjen e objektivave të synuara të strategjisë së organizatës, në parim, nuk do të mbështeten aktivitetet e përshkruara më poshtë:

- Konferencat, mbledhjet e tryezës së rrumbullakët ose ngjarjet e ngjashme nëpër vendtakime (të tilla si hotelet) të cilat nuk janë të hapura dhe lehtësisht të qasshme për qytetarët e rëndomtë;
- Hulumtimet dhe studimet e fizibilitetit, veçanërisht ato në formë të mjeteve për të planifikuar pjesën e mbetur të intervenimit;
- Vizitat studimore jashtë Kosovës.

#### b. Shpenzimet e pranueshme

Që të konsiderohen të pranueshme, kostot duhet t'i plotësojnë kriteret në vijim:

- të jenë të domosdoshme për zbatimin e suksesshëm dhe arritjen e rezultateve të paraqitura të intervenimit;
- kompenzimi për shpenzime ditore dhe të udhëtimit për vullnetarët e angazhuar;
- të jenë të arsyeshme, të justifikuar dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit të sigurt financiar, duke përfshirë planifikimet e drejta dhe të bazuara në çmime të tregut, si dhe efikasitetin e shpenzimeve;
- të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor në fuqi në Kosovë;
- të realizohen gjatë zbatimit të grantit;
- të jenë të përshkruara në buxhetin e propozuar;
- të mund të identifikohen dhe vërtetohen qartazi;

#### c. Shpenzimet e papranueshme

Kostot e paraqitura më poshtë konsiderohen si të papranueshme:

- Pagat për stafin dhe/ose anëtarët tjerë të organizatës/nismës;
- Tarifat për ekspertët nuk lejohen, përveç nëse është absolutisht e domosdoshme për të arritur qëllimin e projektit dhe nëse arsyetohen siç duhet në formularin e aplikimit;
- Dogana dhe tarifatat e importit;
- Borxhet apo pagesat për humbjet;
- Tatimi mbi vlerën e shtuar – TVSH;
- Pagesat e kredive dhe kamatave;
- Kompenzimet për këmbim valutor;
- Shpenzimet e amortizimit të pajisjeve;
- Blerja e tokës ose pasurisë së paluajtshme;
- Blerja e veturës ose gjeneratorit;
- Pagesat e shpenzimeve të mbuluara nga donatorët tjerë;
- Kreditë për palët e treta.

#### 4. PROCEDURA E APLIKIMIT

##### a. Dokumentet e detyrueshme

Përveç formularit të aplikimit, që duhet të plotësohet sipas shabllonit të formularit për grantin e projektit, aplikantët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Nëse aplikanti është individ:
  - o Letërnjoftimi;
  - o Biografia e shkurtër;
  - o Dëshmia që ai/ajo është/ka qenë i/e angazhuar dhe/ose është duke punuar në fushën e përmbledhur në program;
- Nëse aplikanti është iniciativë e peregjistruar:
  - o Përmbledhja/përshkrimi i shkurtër i iniciativës;
  - o Lista e emrave, letërnjoftimet dhe nënshkrimet e anëtarëve kryesorë të iniciativës;
  - o Dëshmia që janë/kanë qenë të angazhuar dhe/ose janë duke vepruar në fushën e përmbledhur në program;
- Nëse aplikantët janë OJQ:
  - o Certifikata e regjistrimit e lëshuar nga Departamenti për OJQ-të;
  - o Certifikata e numrit fiskal;
- Në rast të bashkë-financimit për këtë projekt, nevojitet dëshmia e bashkë-financimit (p.sh. kontrata, vendimi, letra e zotimit, etj.).

Të gjitha dokumentet për aplikim mund të shkarkohen nga ueb-faqja [www.kcsfoundation.org](http://www.kcsfoundation.org).

##### b. Dorëzimi i aplikacioneve

Aplikacionet e kompletuara duhet të dërgohen vetëm përmes formës elektronike në e-mailin [rc-kosovo@kcsfoundation.org](mailto:rc-kosovo@kcsfoundation.org).

E-maili duhet të përmbajë formularin e plotësuar të aplikimit dhe të gjitha dokumentet e obligueshme të specifikuar në thirrjen për aplikim. Nga aplikantët do të kërkohet të vërtetojnë që aplikimi i tyre është i kompletuar, përmes listës kontrolluese të paraqitur në formularin e aplikimit. KCSF do ta konfirmojë pranimin e aplikacionit duke iu përgjigjur aplikantit me një e-mail njoftues. Nuk do të shqyrtohen aplikacionet që nuk janë në përputhje me rregullat e këtyre udhëzimeve.

##### c. Afati i fundit kohor për dorëzimin e aplikacionit

Aplikacionet e Granteve për projektet e vogla mund të dërgohen deri më **31 gusht 2021, në ora 15:00**.



#### d. Kontakti

Për të gjitha pyetjet që keni në lidhje me përgatitjen e dokumenteve për aplikim mund të na kontaktoni në [rc-kosovo@kcsfoundation.org](mailto:rc-kosovo@kcsfoundation.org). Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet do të publikohen në seksionin e pyetjeve dhe përgjigjeve të ueb-faqes së KCSF-së dhe CBM-së.

Aplikantët rekomandohen fuqishëm ta shikojnë kapitullin e pyetjeve dhe përgjigjeve të publikuar në ueb-faqe.

Në lidhje me procesin e aplikimit, ju lutemi ta përdorni vetëm e-mailin e specifikuar për komunikim me KCSF-në.

### 5. VLERËSIMI DHE NJOFTIMI

Vlerësimi i aplikacioneve për grantet për vullnetarizëm do të kryhet në dy faza:

- 1) Kontrolli administrativ (verifikimi i kriterëve formale) dhe
- 2) Vlerësimi përmbajtësor (bazuar në kategoritë dhe kriteret e paracaktuara të vlerësimit).

#### a. Kontrolli administrativ (verifikimi i kriterëve formale)

Gjatë kësaj faze vlerësohen të gjitha aplikacionet, nëse janë respektuar/dërguar kërkesat si më poshtë:

1. Të gjitha kërkesat administrative dhe teknike të paraqitura në formularin e aplikimit;
2. Dokumentet e detyrueshme, përfshirë edhe pranueshmërinë e organizatave;
3. Shumën e kërkuar; dhe
4. Kohëzgjatjen e grantit.

Aplikacionet që nuk i plotësojnë kriteret e specifikuar do të refuzohen.

Rezultatet e përputhshmërisë me kriteret administrative i komunikohen secilit aplikant me shkrim.

#### b. Vlerësimi i aplikacioneve dhe vendimi përfundimtar

Aplikacionet që e kalojnë kontrollin administrativ do të vlerësohen nga ekipi për vlerësimin e granteve (EVG), të përbërë nga tre ekspertë të jashtëm që posedojnë ekspertizë dhe njohuri përkatëse. EVG do t'i vlerësojë propozimet në dy faza: 1) përmes shqyrtimit të dokumenteve dhe 2) intervistave publike.

Ekipi për vlerësimin e granteve do t'i vlerësojë aplikacionet duke u bazuar në këto kriteret:

- Cilësia dhe rëndësia e projektit dhe logjika e intervenimit (40%)
- Angazhimi i qytetarëve dhe angazhimi vullnetar në projekt (40%)
- Përshtatshmëria e kapaciteteve për zbatimin e projektit (10%)
- Efikasiteti i shpenzimeve në buxhetin e propozuar (10%)

Vlerësimi maksimal i aplikacionit është 100 pikë.

Pas vlerësimit fillestar të aplikacionit të dërguar dhe të të gjitha dokumenteve tjera të obligueshme, në listën e ngushtë përzgjedhen aplikantët që fitojnë të paktën **51 pikë** (nga 100), si dhe gjysmën e pikëve në dispozicion (**50%**) për secilën nga katër kategoritë e paraqitura më lart.

Të gjithë aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen për intervistë publike. Intervista e aplikantëve të përzgjedhur në listën e ngushtë do të jetë publike dhe përbëhet nga një prezantim i shkurtër i propozimit të grantit dhe sesionet e pyetjeve dhe përgjigjeve me anëtarët e ekipit për vlerësimin e granteve.

Pas zhvillimit të intervistave, ekipi për vlerësimin e Granteve rekomandon listën e aplikantëve të cilëve do t'u ndahen grantet për implementimin e projektit. Që të merren në konsideratë për t'u financuar, aplikantët duhet të fitojnë të paktën **71 pikë në total**, si dhe gjysmën e pikëve në dispozicion (50%) për secilën nga katër kategoritë e paraqitura më lart. Lista e aplikantëve të rekomanduar për grant do të shqyrtohet në proporcion me kuotën gjeografike, ku të paktën 50% e përfituesve do të jenë organizatat me lokacion dhe veprimtari jashtë Prishtinës.

Donatorët kanë të drejtë vote në listën e aplikantëve të rekomanduar për grant, të cilët konsiderohen se janë në kundërshti me vlerat e promovuara nga donatori ose nëse projekti i propozuar është i ndërthurur me intervenimet tjera të ngjashme.

Aplikantët e suksesshëm, para dhënies së kontratës, do të asistohen nga KCSF përmes një sesioni të mentorimit për të finalizuar dosjen e tyre të implementimit.

c. Njoftimi për vendimin dhe shqyrtimi i ankesave

Secili aplikant do të informohet me shkrim mbi vlerësimin/rezultatit e përgjithshëm. Aplikantët e pasuksesshëm mund të ankohen brenda dy ditëve të punës, prej ditës kur është dërguar emaili i refuzimit. Informacioni mbi përfituesit e përzgjedhur të grantit do të publikohet në ueb-faqen e KCSF-së pas nënshkrimit të kontratave.

## 6. DATAT E RËNDËSISHME

Procesi	Data e planifikuar
Lansimi i Thirrjes për Grantet për vullnetarizëm	<b>28 korrik 2021</b>
<b>Sesionet informuese – Kosovë:</b> *Detajet do të publikohen në <a href="http://kcsfoundation.org">kcsfoundation.org</a>	<b>9-27 gusht 2021</b>
Njoftimi mbi kontrollin administrativ	<b>Shtator 2021</b>
Njoftimi për aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë	<b>Shtator 2021</b>
Intervistat me aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë	<b>Tetor 2021</b>
Vendimi përfundimtar	<b>Tetor 2021</b>
Nënshkrimi i kontratës	<b>Nëntor 2021</b>

*Qendra e Burimeve për Shoqëri Civile në Kosovë është projekt që financohet nga Bashkimi Europian (BE), bashkë-financohet nga Suedia dhe zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Community Building Mitrovica (CBM).*